



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4.3.2025

Nr: 236

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “DJATHTAS PËR ZHVILLIM” (DZH), PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 4.3.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me datë 3.3.2025 me:

**Kërkues:** Subjekti zgjedhor Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Eriselda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako.

**Objekti:** Regjistrimi i koalicionit “Djathtas për Zhvillim” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

**Baza ligjore:** Neni 65 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Subjekti zgjedhor Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Eriselda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako brenda afatit ligjor të përcaktuar ka paraqitur kërkesën me datë 03.03.2025, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e koalicionit “Djathtas për Zhvillim” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Djathtas për Zhvillim” është depozituar marrëveshja e nënshkruar nga kryetarët e partive politike pjesëmarrëse në koalicion, të cilat do të jenë: 1. Partia “Djathtas 1912”, 2. Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”,

Data: 4.3.2025 Nr: 236  
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Djathtas për Zhvillim”, (DZH), për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të 2 (dy) partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “Djathtas për Zhvillim”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “DZH”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Partia Djathtas 1912”;
6. Autorizimin e Z. Rezart Kthupi përfaqësuesi i Partisë “Djathtas 1912” / ose të autorizuarin prej tij, të dorëzojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listat shumemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit;
7. Autorizimin e Z. Rezart Kthupi, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
8. Autorizimin e Z. Rezart Kthupi, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
9. Autorizimin e Z. Rezart Kthupi, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor:

- a) Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.
- b) Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ketë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e koalicionit.
- c) Kushti i tretë është që numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion duhet të jetë dy ose më shumë se dy.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se kërkesa për t’u regjistruar si koalicion, është e bazuar për partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga Z. Arbi Agalliu, Z. Enkelejd Alibeaj, Zj. Eriselda Çelaj, Z. Agron Kapllanaj, Zj. Edlira Devolli, Z. Edvin Kulluri dhe Zj. Eva Vako, i përfaqësuar nga Z. Rezart Kthupi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 206 datë 26.02.2025.
2. Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me bashkëkryetar Z. Dashamir Shehi dhe Z. Eqerem Spahiu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 179 datë 25.02.2025.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 2 partitë e sipërcituara është në përputhje me nenet 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenet 64, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e Koalicionit “Djathtas për Zhvillim”, përfaqësuar nga Z. Dashamir Shehi, me shkronja nistore “DZH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, e përbërë nga subjektet zgjedhore si më poshtë:
  1. Partia “Djathtas 1912” (DJATHHTAS 1912);
  2. Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” (LZHK).
2. Partia udhëheqëse e Koalicionit është “Partia Djathtas 1912”, përfaqësuar nga Z. Dashamir Shehi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**